



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIATEVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Emri i OJQ-së: OJQ - Qendra Mediale për Demokraci, Tolerancë dhe Shoqëri Civile-PEJA


Numri i Regjistrimit: 5102162-2

Drejtor: Xhavit Husaj

OSHMA: Radio Peja

Pronar: OJQ - Qendra Mediale për Demokraci, Tolerancë dhe Shoqëri Civile-PEJA

Adresa: Shtëpia e Kulturës kat. IV, Pejë



VENDIM

për ripërtëritjen e licencës të Ofruesit të Shërbimeve Mediale Audio – Radio Peja, me seli në Pejë

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audio vizuale.
2. Radio Peja është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetim tokësor analog të programeve të radios, me seli në Pejë. KPM, me vendimin e datës 6 tetor 2016, i ka lëshuar licencën Radio Peja për një afat prej shtatë (7) vitesh, ndërsa më datën 6 tetor 2023, skadon afati i licencës së Radio Peja.
3. Me datën 18 prill 2023, KPM përmes e-mail ju ka dërguar shkresë të gjitha radiove të cilave afti i licencës ju skadon licenca në vitin 2023, në mesin e tyre edhe Radio Peja, përmes së cilës shkresë i ka njoftuar lidhur me skadimin e afatit të licencës dhe mundësin e ripërtëritjes së saj në pajtim me Nenin 25 të Ligji Nr. 04/L-44 për Komision i Pavarur të Mediave.
4. Më datën 7 korrik 2023, Radio Peja ka dorëzuar një kërkesë me shkrim në Zyrën Ekzekutive të KPM-së, përmes së cilës ka kërkuar ripërtëritjen e licencës

Arsyetim


5. Neni 25 i Ligjit të KPM-së përcakton: *Përveç rasteve kur KPM-ja konsideron se licenca nuk duhet të ripërtëritjet për shkak të shkeljes së dispozitave materiale nga ana e ofruesit të shërbimit medial audio vizual privat për sa u përket kushteve dhe kritereve të licencimit,*

kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Komisioni brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.

6. Me anë të shkresës së datës 18 prill 2023, lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të licencës, KPM gjithashtu, ka njoftuar Radio Peja lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për ripërtëritjen e licencës.
7. Komisioni konstaton se, Radio Peja përmes kërkesës me shkrim ka shprehur interesim për vazhdimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve mediale audio (radio) në lokacionin për të cilin është licencuar.
8. Komisioni konstaton se Radio Peja ka shlyer të gjitha obligimet financiare ndaj KPM - së, përfshirë këtu edhe pagesën e tarifës administrative për ripërtëritje të licencës, e paraparë me Rregulloren KPM-2017/06.
9. Komisioni konsideron se nuk janë evidentuar shkelja të tilla të dispozitave materiale të Ligjit dhe akteve nënligjore të KPM-së, nga ana e ofruesit të shërbimit medial, Radio Peja të cilat shkelje do të pamundësonin ripërtëritje të licencës.
10. Komisioni vlerëson se kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Peja është dorëzuar në pajtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së dhe si e tillë kërkesa për ripërtëritjen e licencës së Radio Peja i plotëson kushtet për miratim dhe se ripërtëritja e licencës është në interesin e publikut në zonën në të cilën transmeton kjo radio.

Vendim

11. Komisioni merr vendim për ripërtëritjen e licencës për Radio Peja, në mënyrë që të vazhdojë me veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve mediale audio, e cila veprimtari është në interes të publikut në lokacionin për të cilin është licencuar dhe në të cilin është duke transmetuar program Radio Peja.
12. Licenca e Radio Peja do të jetë e vlefshme për një afat prej shtatë (7) vitesh, ashtu siç është përcaktuar me Nenin 21, paragrafin 2, të Ligjit për KPM-në, ndërsa vlefshmëria e afatit të licencës do të llogaritet nga data 06 tetor 2023.
13. Të gjitha parametrat e licencës së Radio Peja, siç janë: kategoria e të licencuarit, skema programore, parametrat teknike dhe harta e zonës së mbulimit do të mbesin të pandryshuar nga licenca paraprake.
14. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



13.10.2023

Data